

**Nr. Prot. 066/B/17**

## VENDIM Nr. 1083

**Për**

### **Shtyerjen e Afatit për çregjistrimin e SIM kartelave të parapaguesve (persona fizik), të cilët kanë më tepër se dhjetë (10) SIM kartela në emrin e tyre**

Në mbështetje të neni 10, paragrafi 4), neni 67, neni 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores nr. 30 për regjistrimin e parapaguesve të telefonisë mobile (*Ref. Nr.Prot.007/B/17;tutje referuar si - Rregullorja*), kërkesës së operatorëve IPKO Telecommunications LLC dhe Telekom i Kosovës SH.A. (*tutje referuar si - operatorët*) të datës 09/11/2017 (*Ref. e-mail: Thursday, November 09, 2017 2:55 PM*), dhe nenit 13 të Statutit (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 23 - të mbajtur më datë 24 Nëntor 2017, pas shqyrtimit të materialit dhe Rekomandimit të DKE, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e operatorëve për shtyerjen e afatit për çregjistrimin e SIM kartelave të parapaguesve (persona fizik), të cilët kanë më tepër se dhjetë (10) SIM kartela në emrin e tyre.
- II. Obligohen operatorët që deri më datë 01 Korrik 2018 të përfundojnë procesin e çregjistrimit të parapaguesve (persona fizik) të specifikuar në paragrafin I) të këtij vendimi.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Më datë 09/11/2017 (Ref. e-mail: Thursday, November 09, 2017 2:55 PM), operatorët Telekom i Kosovës SH.A. dhe IPKO Telecommunications LLC kanë dërguar shkresë në ARKEP, përmes së cilës kanë kërkuar një afat shtesë prej 6 muajsh për çregjistrimin e parapaguesve të telefonisë mobile sipas nenit 9 të Rregullores.

Sipas shkresës në fjalë, që nga miratimi i Rregullores operatorët kanë zhvilluar menjëherë planin për përshtatjen e kërkesave të dala nga Rregullorja në sistemet e brendshme duke bërë implementimin teknik të limitimit të shitjes së numrave për të gjithë Parapaguesit fizik, dhe po ashtu duke njoftuar në mënyrë sistematike parapaguesit me mbi 10 SIM kartela për procedurat e çregjistrimit sipas Rregullores në fjalë.

Duke qenë se ky proces ka qenë një sfidë në vete marrë parasysh vështirësitë në raport me Parapaguesit si dhe neglizhencën e tyre për t'ju përgjigjur njoftimeve tona të vazhdueshme për tu paraqitur në pikat tona të shtijës për çregjistrim, është konsideruar e nevojshme që të zgjatet afati për çregjistrimin e Parapaguesve fizik me më tepër se dhjetë (10) SIM kartela në emrin e tyre se paku edhe për një periudhë 6 mujore, **gjegjësisht deri në fund të muajit qershor 2018.**

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Neni 67 paragrafi 1) i Ligjit përcakton se:

*“Ndërmarrësit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike janë të obliguar që të regjistrojnë të gjithë parapaguesit, pavarësisht a janë me kontratë apo të parapaguar, para aktivizimit të shërbimit.”*

Neni 9, paragrafi 2 i Rregullores specifikon si në vijim:

*“Të gjithë parapaguesit aktual, të cilët janë persona fizik dhe kanë më tepër se dhjetë (10) SIM kartela në emrin e tyre obligohen që të bëjnë çregjistrimin e SIM Kartelave të tyre brenda periudhës prej 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.”*

Duke pas parasysh atë që u tha më lart është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 12/12/2017**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Vendimi i dërgohet:**

- Telekom i Kosovës Sh.A.;
- IPKO Telecommunications LLC;
- Departamenti të Komunikimeve Elektronike (DKE), ARKEP
- Departamenti Ligjor (DL), ARKEP
- Arkivës së ARKEP